



Office of the United Nations Resident Coordinator

Shpërblimi i Kombeve të Bashkuara për Gazetari dhe Fotografi 2009

Tradicionalisht, me rastin e Javës Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Varfërisë (17 – 24 tetor), Organizata e Kombeve të Bashkuara në shtet do të shpërndajë shpërblimet për arritje të mëdha në raportimin gazetaresk dhe fotografi lidhur me **çështjet e varfërisë** në vend. Këtë vit gjithashtu, Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara do të shpërndajë shpërblimet vijuese në katër kategoritë:

- **Artikulli më i mirë i shtypur** (vendi i parë, i dytë, i tretë)
- **Artikulli (Kronika) më e mirë televizive** (vendi i parë, i dytë, i tretë)
- **Artikulli (Pakoja) më e mirë në radio** (vendi i parë, i dytë, i tretë)
- **Fotografia më e mirë** (vendi i parë, i dytë, i tretë)

Fituesit do të shpallen gjatë Javës Ndërkombëtare për Zvogëlimin e Varfërisë (17 – 24 tetor 2009).

Kriteret:

Gazetaria si profesion ka një rol të rëndësishëm në krijimin dhe drejtimin e opinionit (mendimit) publik dhe të vetëdijes në shoqëri, si edhe në arritjen e qëllimeve zhvillimore të vendit. Për këtë qëllim, KB i inkurajojnë gazetarët që të zhvillojnë hulumtime (kërkime), të praktikojnë informimin cilësor, të hapin debate dhe iniciojnë veprime në temat e varfërisë dhe përjashtimet sociale. Në kategoritë për tregime/ artikuj më të mirë në mediumet e shtypura, TV dhe radio, prioritet do t'ju jepen atyre tregimeve/ artikujve të cilat:

- përfshijë qasje më të gjerë, analitike të temës në fjalë;
- tregojnë hulumtime dhe aspekte analitike;
- nuk raportojnë vetëm për një rast të izoluar;
- bëjnë ndërlidhje, nxjerrin konkluzione, i lidhin me agjendën sociale më të gjerë

Vlera e shpërblimeve:

1. Shpërblimi i parë = 500 USD
2. Shpërblimi i dytë = 300 USD
3. Shpërblimi i tretë = 200 USD

Aplikimet:

- Ky konkurrim është i hapur vetëm për autorët – të lirë ose të puntsuar në mediumet në tërë shtetin. Nënshetësit e huaj nuk kanë të drejtë që të marrin pjesë.
- Materialet e dorëzuara duhet që të jenë botuar në ndonjërin prej mediumeve të vendit, në eridhën midis 12 tetorit 2008 dhe 27 shtatorit 2009, ma datë të qartë dhe të dukshme të shënuar në ta.
- Aplikimi i kompletuar duhet domosdo të përmbajë: 1) Formularin për aplikim me kontakt detajet e nevojshme, së bashku me 2) kopje të artikullit/ tregimit/fotografisë të publikuar, si edhe referencën se kur dhe ku ata kanë qenë të publikuar. Rekomandohet që artikujt e radios dhe televizionit të dorëzohen në CD/DVD.
- Me hyrjen në konkurrencë, konkurruesit në të gjitha kategoritë pranojnë që materiali i tyre të mundet të riprodhohet në botimet e KB ose të përdoret në evenimentet e tjera promovuese.
- Adresa e dorëzimit: United Nations Office Skopje (Zyra e Kombeve të Bashkuara Shkup), Njësia për komunikime, 8-ma Udarina Brigada 2, 1000 Shkup, ose me e-mail në: journalism.mk@undp.org.
- **Afati i fundit për dorëzimin është ditën e diel, 27 shtator 2009.**